

VENDIM
Nr.718, datë 23.6.2009

PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË PERSONELIT TË HETIMIT, TË INSPEKTIMIT DHE TË SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE, NË SHËRBIMIN E KONTROLLIT TË BRENDSHËM, NË MINISTRINË E BRENDSHME

(Ndryshuar me VKM nr. 619, datë 8.7.2010)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 51 të ligjit nr.10 002, datë 6.10.2008 “Për shërbimin e kontrollit të brendshëm, në Ministrinë e Brendshme”, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.10 025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e personelit hetues me grada, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të jenë sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Paga bazë mujore për gradë (kolona 3) e lidhjes nr.1, është niveli i pagës së punonjësit hetues, në përputhje me gradën, që ka fituar.

3. Shtesa për natyrë të veçantë pune dhe shërbimi (kolona 4) e lidhjes nr.1, jepet sipas funksioneve, të përcaktuara në këtë lidhje.

4. Punonjësi hetues me grada, për kohën e qëndrimit në gradë, përfiton shtesë për vjetërsi në punë, në masën 1 për qind, pas çdo viti pune. Masa e shtesës për vjetërsi në punë të jetë deri në nivelin e pagës bazë të gradës pasardhëse.

Përlllogaritja e shtesës për vjetërsi në punë të fillojë në çastin e marrjes së gradës së re, sipas ligjit nr.10 002, datë 6.10.2008 “Për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm, në Ministrinë e Brendshme”.

5. Punonjësit e personelit hetues, të cilët emërohen këshilltarë të drejtorit të përgjithshëm të SHKB-së dhe që në çastin e emërimit kanë të drejtë të fitojnë gradën pasardhëse, të trajtohen në pagë, sipas kësaj grade të fituar.

6. Struktura dhe nivelet me pagave për punonjësit civilë të inspektimit dhe për punonjësit mbështetës të jenë sipas lidhjes nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

7. Kategoria e pagës për punonjësit civilë të inspektimit dhe për punonjësit mbështetës përcaktohet sipas kolonës 3 të lidhjes nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

8. Paga e grupit (kolona 4) e lidhjes nr.2, është sipas lidhjes nr.3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

9. Shtesa për vjetërsi në punë (kolona 5) për punonjësit e inspektimit dhe punonjësit mbështetës është në masën 2 për qind, për çdo vit, por jo më shumë se 25 vjet, dhe llogaritet mbi pagën e grupit.

10. Shtesa për pozicion është sipas kolonës 6 të lidhjes nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

11. Shtesa për natyrë të veçantë pune për punonjësit e inspektimit është sipas kolonës 7 të lidhjes nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

12. Kategorizimi i pozicioneve “Specialist”, të cilët trajtohen në pagë sipas lidhjes nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi, miratohet me urdhrin e miratimit të strukturës dhe të organikës së këtij institucioni.

13. Specialistët, përgjegjësit e sektorit apo drejtorët në Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm, që punojnë në pozicione, që lidhen me procesin e informatizimit të veprimtarisë së këtij shërbimi dhe kërkojnë”, në mënyrë të detyrueshme, arsimin e lartë në degët “Inxhinieri elektronike” apo “Informatikë”, përfitojnë një shtesë për kushte pune, prej 10 000 (dhjetë mijë) lekësh mbi pagën mujore të gradës përkatëse. Zbatimi i kësaj shtese për pozicionet konkrete bëhet pas miratimit paraprak të Departamentit të Administratës Publike dhe Ministrisë së Financave, sipas përshkrimit të pozicioneve të punës.

14. Vendimi nr.558, datë 16.8.2006 i Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve të Policisë së Shtetit”, i ndryshuar, nuk zbatohet më për punonjësit e Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm.

15. Efektet financiare për paga e sigurime shoqërore, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e buxhetit të vitit 2009, miratuar për rritjen e pagave të punonjësve të institucioneve buxhetore.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 maj 2009.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha
Lidhja nr.1

**STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E PERSONELIT HETUES
TË SHËRBIMIT TË KONTROLLIT TË BRENDSSHËM**
(Zëvendësuar me VKM nr. 619, datë 8.7.2010)

Nr.	Grada	Funksionet organike	Paga bazë për gradë	Shtesa për natyrë të veçantë pune
	1	2	3	4
1	Asistent	Ndihmësspecialist në provë në trupën operacionale	35 600	6 500
2	Agjent	Ndihmësspecialist në trupën operacionale	38 700	8 000
3	Agjent i I-rë	Drejtues grupi/ndihmësspecialist në trupën operacionale	43 700	8 000
4	Hetues	Specialist hetimi në nivel vendor Specialist hetimi në nivel vendor në provë	53 100	8 000
5	Hetues i I-rë	Specialist hetimi në nivel vendor	66 200	8 000
	Hetues i I-rë	Specialist hetimi në nivel qendror Shef seksioni në nivel qendror Shef sektori në nivel vendor	75 300	10 000
6	Drejtues	Shef seksioni në nivel qendror Shef sektori në nivel vendor Shef sektori në nivel qendror	81 600	10 000
7	Drejtues i I-rë	Shef sektori në nivel qendror Drejtor drejtorie në nivel vendor Drejtor drejtorie në nivel qendror	91 600	10 000
8	Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm	Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm (Drejtor i Departamentit të Hetimit)	96 400	15 000
9	Drejtor i Përgjithshëm	Drejtor i Përgjithshëm	104 400	20 000

Lidhja nr.2

**STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE PËR PUNONJËSIT CIVILË INSPEKTUES DHE
MBËSHTETËS TË SHËRBIMIT TË KONTROLLIT TË BRENDSSHËM**
(Zëvendësuar me VKM nr. 619, datë 8.7.2010)

Nr.	Klasifikimi i niveleve	Funksionet organike	Kategoria e pagës	Paga e grupit	Shtesa për vjetërsi	Shtesa e pozicionit	Shtesa për natyrë të veçantë pune
	1	2	3	4	5	6	7
1	Punonjës të nivelit të lartë drejtues	Drejtor i Drejtorisë së Inspektimit	II-b	1	2%	88 000	
2	Punonjës të nivelit të mesëm drejtues	Drejtor në nivel qendror (për shërbimet mbështetëse)	III-a	1	2%	71 000	
3	Punonjës të nivelit bazë	Shef sektori në nivel qendror (në Drejtorinë e Inspektimit)	III-a	1	2%	71 000	5000

	drejtues						
4	Punonjës të nivelit bazë zbatues	Inspektor në nivel qendror (në Drejtorinë e Inspektimit)	III-b	1 ose 2	2%	54 000	5000
		Specialist në nivel qendror	III-b	1 ose 2	2%	54 000	
		Specialist trajnimi në nivel qendror për punonjësit e SHKB-së	IV-a	1 ose 2	2%	43 000	5000
		Specialist në nivel qendror	IV-a	1 ose 2 ose 3	2%	43 000	
		Specialist në nivel qendror	IV-b	1 ose 2 ose 3	2%	33 000	

Lidhja nr.3

VLERA E PAGËS SË GRUPIT PËR GRUPET E DIPLOMAVE TË ARSIMIT UNIVERSITAR
(Shtuar me VKM nr. 619, datë 8.7.2010)

Grupi i diplomës	Lloji i diplomës	Vlera
1	Diplomë e Nivelit të Dytë (DND) Diplomë e Integruar e Nivelit të Dytë (DIND) Të barasvlefshme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë	12 000 lekë
2	Diplomë e Nivelit të Parë (DNP) apo të barasvlefshme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë + Master i Nivelit të Parë (MNP)	11 000 lekë
3	Diplomë e Nivelit të Parë (DNP) Të barasvlefshme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë	10 000 lekë